



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:180692

Datë: 25.07.2024

Numri i dokumentit: 05978552

P.nr.479/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Erblina Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurit F. Sh., për shkak të veprës penale "Rrezikimi i trafikut publik" nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.4343/23, të datës 12.10.2023, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 23.07.2024, në praninë e përfaqësueses së akuzës prokurores së shtetit Ardiana Veseli, përfaqësuesit të dëmtuarës tani të ndjerë R. S., të pandehurit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. F. Sh., me datë 24.07.2024 dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 25.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F. SH., nga i ati S. dhe nëna Xh., mbiemri i vajzërisë së nënës S., i lindur më ... në fshatin B., Komuna P., me vendbanim në rrugën "I." nr. ... në P., me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion taksist, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

I. Me datë 19.05.2023, rreth orës 21:05, në rrugën lokale B.- Ll., në fshatin G., Komuna P., i pandehuri F. Sh., duke vepruar në kundërshtim me nenin 53, nenin 41 dhe nenin 65 të Ligjit, dhe me këtë nga pakujdesia shkaktonte aksident trafiku, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që natën kritike deri sa i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e tipit "V. G.", ngjyrë e k., me targa ..., ku ne veturë kishte pesë pasagjerë të tjerë, me të arrit në lokacionin e lartcekur gjatë ngasjes së automjetit në drejtim të B. si pasojë e mos respektimit të rregullave të komunikacionit për ngasjen e obliguar në anën e djathtë dhe moskujdesit në ngasje, ka kaluar përtej mesit të rrugës në shiritin e majtë (anën) që i takonte për lëvizje shiritin e majtë, dhe si pasojë e shpejtësisë të papërshtatshme dhe manovrimit të përshpejtuar duke u lakuar në rrugën e cila ka qenë e lakuar – kthesë djathtas me pjesën e parë e godet automjetin e tipit "M. ... ..", ngjyrë h. – m., me targa ..., të cilën e drejtonte i dëmtuari D. P., me ç' rast si rrjedhojë e këtij aksidenti lëndime lehta trupore pësojnë pasagjeret e veturës "V. G.", të dëmtuarit A. Sh., A. Sh., A. Sh., Sh. Sh. dhe i demtuari D. P., që si të tilla

paraqesin lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshëm për shëndetin, lëndime këto të përshkruar me hollësisht në Akt ekspertimin mjeko ligjore të Dr.F. B., të datës 08.08.2023, ndërsa lëndime të renda trupore pëson e dëmtuara tani e ndjera Xh. Sh., e cila si pasojë e lëndimeve të renda trupore, të pësuar nga ky aksident, në baze të raportit të autopsisë, është konstatuar se me datën 21.05.2023, në ora 15:55 minuta, tani e ndjera Xh. Sh., ka ndërruar jetë në Q... –P..

- me këtë ka kryer veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 73 par. 1 dhe 74 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së i pandehuri;

## LIROHET NGA DËNIMI

I. Për arsye se pasojat e kësaj vepre penale të pandehurën e kanë goditur aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

II. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej njëzet (20) Euro, për ekspertizë mjeko-ligjore shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, për ekspertizë të komunikacionit shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) Euro, ndërsa në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

III. Përfaqësuesi i të ndjerës Xh. Sh. - vëllai R. S., me vendbanim në Rr. “Xh. M.”, nr. ..., lagja V., P., shprehimisht ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP/II.nr.4343/23, të datës 12.10.2023, kundër të pandehurit F. Sh., për shkak të veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjyqtari i vetëm gjykues ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 23.07.2024, pas hapjes së seancës, konstatimit të prezencës së palëve, udhëzimit për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit në kuptim të nenit 241 par. 4 të KPP-së i është ofruar mundësia e deklaramit rreth fajësisë – të pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ka shprehur keqardhje dhe është tronditur nga kjo ngjarje tragjike për faktin se në këtë aksident trafiku ka ndërruar jetë nëna e tij, arsye kjo të cilën kërkoi nga gjykata ta merr parasysht si rrethanë të posaçme dhe t’i shqiptojë një sanksion më të butë penal.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimit të mjaftueshëm me avokatin mbrojtës të tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj gjatë marrjes në konsideratë të pranimit të fajësisë nga i njëjti,

gjqytari i vetëm gjykues mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit dhe përfaqësuesit të tani të ndjerës R. S..

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ngase pranimi i fajësisë është bërë me vullnetin e tij të plotë pas konsultimit me mbrojtësin e tij, pranim ky i cili është në përputhje me shkresat e lëndës, andaj me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin të merr parasysh pranimin e fajësisë, si dhe faktin se viktimja nga ky aksidenti tani e ndjerë është nëna e të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit av. F. Sh., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se: meqenëse ky rast tragjik ka ndodhur nga pakujdesia e të pandehurit, nga gjykata kërkoi që duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 74 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së, të pandehurin ta shpallë fajtor dhe liroi nga dënimi, kjo duke qenë se pasoja e shkaktuar – vdekja e nënës për të cilën është kujdesur, e ka goditur aq rëndë këtë të fundit i cili edhe tani ndjenë keqardhje, përveç kësaj, si rrethana tjera lehtësuese për të pandehurin gjykata të merr parasysh faktin se i njëjti për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, është mbajtës i vetëm i familjes, baba i tre fëmijëve të mitur dhe çdo sanksion tjetër do të vështirësonte tej mase mirëqenien e familjes së tij.

Përfaqësuesi i të ndjerës R. S. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri me të cilin është në raport juridik familjar gjegjësisht daja i këtij të fundit, ngjarja tragjike ka tronditur dhe ka shkaktuar dhembje tek të gjithë familjarët, nga gjykata ka kërkuar që i pandehuri të lirohet nga dënimi.

Gjqytari i vetëm gjykues pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri si dhe marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, përfaqësuesit të tani të ndjerës, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës si: Raportit të aksidentit me nr. ... i datës 19.05.2023, Skica e aksidentit e datës 1.05.2023, Certifikata e regjistrimit të automjetit e tipit “V. G.”, ngjyrë e k., me targa ..., në emër të Sh. Sh., Certifikata e regjistrimit të automjetit e tipit “m. ... ..”, ngjyrë h. M., me targa ..., në emër të N. P., Raporti mjekësor i të dëmtuarit D. P. me nr. prot. ... i datës 19.05.2023, Raporti mjekësor i të dëmtuarit A. Sh. me nr. prot. ... i datës 19.05.2023, Raporti mjekësor i të dëmtuarit A. Sh. me nr. prot. . i datës 19.05.2023, Raporti mjekësor i të dëmtuarit A. Sh. me nr. prot. ... i datës 19.05.2023, Raporti mjekësor i të dëmtuarës Sh. Sh. me nr. prot. . i datës 19.05.2023, raporte këto të lëshuara nga Q... – Klinika Emergjente P., Certifikata e të ndjerës Xh. Sh., Akt Ekspertimi mjeko ligjor, punuar nga Dr. F. B. i datës 08.08.2023, Raporti i Autopsisë me nr. ..., i datës 15.06.2023, Ekspertiza e aksidentit të komunikacionit e datës 25.08.2023, Fotografitë e vendit të ngjarjes, Deklarata e të dëmtuarit D. P. dhënë në polici me datë 21.05.2023, ndërsa në prokurori me datë 05.09.2023, Deklarata e përfaqësuesit të të ndjerës Xh. Sh. vëllai R. S. dhënë në prokurori me datë 05.09.2023, Deklarata e të pandehurit F. Sh. dhënë në polici me datë 10.06.2023 dhe në prokurori me datë 05.09.2023, Plotësimi i deklaratës së të pandehurit F. Sh. e datë 26.09.2023, Deklarata e bashkësisë familjare me nr. rendor 19/19001/6 e datës 10.05.2022, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, konstaton se në veprimet inkriminuese të pandehurit të kryera nga pakujdesia, përmbushen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale “Rrezikimi i trafikut publik” nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, andaj pasi që më parë gjeti se në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, të njëjtën e shpalli fajtor dhe e ka liruar nga dënimi.

Nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe fakti se tani e ndjera Xh. Sh. është nëna e të pandehurit, në kuptim të nenit 73 par. 1 dhe 74 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së, të njëjtin e ka shpallur fajtor, mirëpo meqenëse tragjedia personale cila është shkaktuar me vepër penale apo

pasoja e veprës penale e kryer nga pakujdesia e ka goditur aq rëndë të pandehurin, të njëjtin e ka liruar nga dënimi ngase bazuar në këto fakte dhe rrethana, si dhe dispozitave ligjore të sipërcituara sipas bindjes së gjykatës shqiptimi i ndonjë dënimi do të ishte jo human, jo i drejtë dhe i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242, 365 par. 1 të KPP-së dhe të neneve 73 par. 1 dhe 74 par. 1 nën-par. 1.1 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal  
P.nr. 47/23, Datë 25.07.2024

Procesmbajtëse  
Erblina Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Besnik Sheqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.